REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr 2158 Prot Vlorë, më 21.10 2026

PROJEKTVENDIM
Nr._____, datë _____._____. 2026

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2027

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika ç, d dhe dh, të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, VKM-në nr. 103, datë 11.2.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM-në nr. 87, datë 6.2.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, Ligjin nr. 35/2023 Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera Financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" dhe VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, institucioneve të vartësisë dhe funksioneve të deleguara - 2026" i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë si vijon:

• Administrata e Bashkisë Vlorë	405 punonjës
• Konvikti (Arsimi profesional)	16 punonjës
• Çerdhet	23 punonjës
• Arsimi (Punonjës jomësimor/ mësues ndihmës dhe Inspektor QKF)	61 punonjës
• Qendra Ditore e të Moshuarve	4 punonjës
• Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	14 punonjës
• Qendra Kulturore	32 punonjës
• Teatri "Petro Marko"	31 punonjës
• Klubi Shumësportësh "Flamurtari"	17 punonjës

- Qendra e Zhvillimit PAK 22 punonjës
- Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen 11 punonjës
- Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane 40 punonjës
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 187 punonjës
  - *Sektori i Ndriçimit* *25 punonjës*
  - *Sektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD* *104 punonjës*
  - *Sektori i mirëmbajtjes së varrezave* *30 punonjës*
  - *Bordi i Kullimit* *24 punonjës*
  - *Rrugët rurale* *4 punonjës*
- Ndërmarrja e Pastrimit (Pastrim, Gjelbërim) 363 punonjës

2. Të miratojë numrin e punonjësve në strukturën e Bashkisë ardhur me grant të kushtëzuar:

- Zyra e Gjendjes Civile 14 punonjës
- Arsimi parashkollor / punonjësit jomësimor (sistemi 9 vjeçar) 355 punonjës
- Arsimi i mesëm punonjes jomësimor 51 punonjës
- Drejtoria e MZSH 50 punonjës

3. Të miratojë klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë, si më poshtë:

Administrata e Bashkisë Vlorë
Tabela nr. 1

Pozicioni	**Klasa**	**Shtesa për pozicion**
Kryetar		297,250
Zv/Kryetar		230,625
Këshilltar	II-2	144,525
Drejtor Kabineti	I-5	174,250
Sekretar Këshilli	I-5	174,250
Sekretar kryetari/Specialist	IV-4	65,000
Administrator Rajoni	III-3	102,000
Administrator NJ.A		148,625
Drejtor i Përgjithshëm	I-5	174,250
Drejtor Drejtorie	II-2	144,525
K/Inspektor	III-2	109,000
Përgjegjës	III-2	109,000
Specialist	IV-2	85,000
Specialist	IV-3	75,000
Inspektor	IV-2	85,000
Përgjegjës	III-3	102,000 +7,500
Specialist IT	IV-2	85,000 +7,500
ND		57,000
Elektricist		57,000
Inspektor i Policisë Bashkiake		67,000

Punonjës P. Bashkiake		63,000

Çerdhet	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	102,000
Kujdestar	IV-3	75,000
Kujdestar		57,000
ND/MB		57,000

Konvikti (Arsimi profesional)
Tabela nr. 2

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	102,000
Ekonomist	IV-2	85,000
Punonjës edukativ	IV-2	85,000
ND/MB		57,000

Arsimi	Klasa	Shtesa për pozicion
Mësuese ndihmese/ Inspektor QKF		
ND		57,000

Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara
Tabela nr. 3

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Psikolog	IV-2	85,000
Punonjës Social	IV-2	85,000
Logoped	IV-2	85,000
Fizioterapist	IV-2	85,000
Edukatore	IV-3	75,000
Pastruese		57,000

Qendra e Kulturës
Tabela nr. 4

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Përgjegjës	III-3	102,000
Punonjës	IV-2	85,000
Punonjës	IV-3	75,000
ND/MB		57,000

Teatri Petro Marko
Tabela nr. 5

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Përgjegjës	III-3	102,000
Punonjës	IV-2	85,000
Punonjës	IV-3	75,000
ND/MB		57,000

Klubi Shumësportësh "Flamurtari"
Tabela nr. 6

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Financier	III-3	102,000
Specialist	IV-2	85,000
Inspektor	IV-3	75,000
ND/MB		57,000

Qendra e Zhvillimit PAK
Tabela nr. 7

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kujdestare/Edukatore	IV-3	75,000
Infermier/Logoped	IV-2	85,000
Kujdestare		57,000
ND		57,000

Ndërmarrja Publike per Menaxhimin e Mbetjeve Urbane
Tabela nr. 8

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Përgjegjës	III-3	102,000
Specialist	IV-2	85,000
Specialist	IV-3	75,000
MB		57,000
ND		57,000

Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen
Tabela nr. 9

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	102,000
Psikolog	IV-2	85,000
Punonjës Social	IV-2	85,000

Kujdestare	IV-3	75,000
Kujdestare alternative		57,000
Pastruese		57,000

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
Tabela nr. 10

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Përgjegjës	III-2	109,000
Përgjegjës	III-3	102,000
Specialist	IV-2	85,000
Specialist	IV-3	75,000
ND/MB		57,000
Elektricist		57,000
Punëtor		57,000

Ndërmarrja e Pastrimit(Pastrim, Gjelbërim)
Tabela nr. 11

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	144,525
Përgjegjës	III-2	109,000
Përgjegjës	III-3	102,000
Specialist	IV-2	85,000
Specialist	IV-3	75,000
ND/MB		57,000
Punëtor		57,000

4. a. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:
   i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
   iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

b. Punonjësit administrativë, punonjësit mbështetës dhe punonjësit e Policisë Bashkiake përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

5. Punonjësit e Policisë Bashkiake do të përfitojnë shtesë për vështirësi në punë 4.000 (katër mijë) lekë muaj.

6. Punonjësit mbështetës dhe punonjësit e specialiteteve do të përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 4.000 (katër mijë) lekë në muaj.

7. Fondi i pagës për punonjësit e Bashkisë, Institucionet e varësisë dhe funksioneve të transferuara pasqyrohet në buxhetin e Bashkisë Vlorë 2027.

8. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

9. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr 2158 prot. Vlorë, më 2 / 10 2026

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2027"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Projektvendimi që i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak hartohet në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8, pika 2, dhe neni 9, pika 1.1, shkronja "b", sipas të cilave njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, nxjerrin akte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Në mënyrë të veçantë, neni 54 i këtij ligji i njeh Këshillit Bashkiak kompetencën që, sipas shkronjës "ç", të miratojë "nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi" dhe, sipas shkronjës "dh", të miratojë "edhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë".

Për përcaktimin e niveleve të pagave, projektvendimi mbështetet në Ligjin nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.5.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar me VKM-në nr. 103, datë 11.2.2026, si dhe në VKM-në nr. 326, datë 31.5.2023, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar me VKM-në nr. 87, datë 6.2.2026.

Numri i punonjësve për vitin 2026 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 98, datë 27.11.2025, "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, institucioneve të vartësisë dhe funksioneve të deleguara – 2026", i ndryshuar, në masën 1.627 punonjës. Projektvendimi për vitin 2027 përgatitet njëkohësisht me projektbuxhetin e vitit 2027,

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, me qëllim që numri i punonjësve dhe fondi i pagave të planifikohen në mënyrë të bashkërenduar dhe të qëndrueshme.

Qëllimi i projektvendimit është përshtatja e kapaciteteve njerëzore të Bashkisë dhe të institucioneve të saj të varësisë me ngarkesën reale të punës, të evidentuar gjatë vitit 2026, dhe me detyrimet që ligji i ngarkon Bashkisë për ofrimin e shërbimeve publike dhe për administrimin e të ardhurave të veta.

I. Për pikat 1 dhe 2 të projektvendimit – numri i punonjësve për vitin 2027

Me pikën 1 të projektvendimit propozohet miratimi i numrit të punonjësve të Bashkisë dhe të institucioneve të varësisë, si vijon:

- Administrata e Bashkisë Vlorë – **405 punonjës**;
- Konvikti (Arsimi profesional) – **16 punonjës**;
- Çerdhet – **23 punonjës**;
- Arsimi (punonjës jomësimorë / mësues ndihmës dhe inspektor QKF) – **61 punonjës**;
- Qendra Ditore e të Moshuarve – **4 punonjës**;
- Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara – **14 punonjës**;
- Qendra Kulturore – **32 punonjës**;
- Teatri "Petro Marko" – **31 punonjës**;
- Klubi Shumësportësh "Flamurtari" – **17 punonjës**;
- Qendra e Zhvillimit PAK – **22 punonjës**;
- Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen – **11 punonjës**;
- Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane – **40 punonjës**;
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike – **187 punonjës**;
  - *Sektori i Ndriçimit – 25 punonjës;*
  - *Sektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD – 104 punonjës;*
  - *Sektori i mirëmbajtjes së varrezave – 30 punonjës;*
  - *Bordi i Kullimit – 24 punonjës;*
  - *Rrugët rurale – 4 punonjës;*
- Ndërmarrja e Pastrimit (pastrim, gjelbërim) – **363 punonjës**.

Me pikën 2 propozohet miratimi i numrit të punonjësve të strukturave që financohen me grant të kushtëzuar, për funksionet e deleguara nga qeverisja qendrore:

- Zyra e Gjendjes Civile – **14 punonjës**;
- Arsimi parashkollor / punonjës jomësimorë (sistemi 9-vjeçar) – **355 punonjës**;
- Arsimi i mesëm, punonjës jomësimorë – **51 punonjës**;
- Drejtoria e MZSH – **50 punonjës**;

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Numri gjithsej i punonjësve për vitin 2027 propozohet në **1.696 punonjës**, kundrejt 1.627 punonjësve të miratuar për vitin 2026. Rritja neto është **69 pozicione**, ose 4,2% e numrit aktual.

II. Konteksti territorial dhe funksional

Bashkia Vlorë administron një territor të gjerë dhe të larmishëm, të organizuar në 5 njësi administrative (Vlorë, Orikum, Qendër, Novoselë dhe Shushicë), që përfshin dy qytete, Vlorën dhe Orikumin, dhe 37 fshatra. Sipas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 të INSTAT, në territorin e Bashkisë jetojnë 83.683 banorë. Megjithatë, ky tregues nuk e pasqyron plotësisht ngarkesën e shërbimeve publike. Vlora është qytet bregdetar me vijë të gjatë bregdetare dhe gjatë sezonit turistik numri i personave që përdorin rrugët, plazhet, sheshet dhe hapësirat publike rritet ndjeshëm, duke e shumëfishuar kërkesën për pastrim, ndriçim, mirëmbajtje dhe siguri.

Gjatë vitit 2026, administrata e Bashkisë ka evidentuar disa problematika që lidhen drejtpërdrejt me kapacitetet njerëzore të strukturave përgjegjëse:

- investimet publike në zbatim, si programi i rehabilitimit të rrugëve, rikualifikimi urban i Bllokut të Orizit dhe i bllokut "Isa Boletini", shtojnë çdo vit sipërfaqen e rrugëve, trotuareve, rrjetit të ndriçimit dhe hapësirave të gjelbra që duhet të mirëmbahen nga ndërmarrjet e Bashkisë;
- territori fushor i Vlorës, Nartës, Novoselës dhe Shushicës varet nga funksionimi i rrjetit të kanaleve kulluese. Ndërhyrjet e vitit 2026, përfshirë pastrimin e kanalit të Naunkës në muajin gusht, treguan se mirëmbajtja e kanaleve kërkon skuadra të përhershme dhe jo vetëm aksione periodike;
- ngarkesa e sezonit turistik në Lungomare, në Sheshin e Flamurit, në qendrën historike dhe në plazhet publike përballohet sot duke shkëputur punonjës nga zona të tjera të qytetit, të cilat mbeten përkohësisht me shërbim të reduktuar;
- administrimi i taksave dhe tarifave vendore është i shpërndarë ndërmjet disa strukturave, ndërsa zbatimi i Ligjit nr. 86/2025, datë 12.12.2025, për shuarjen dhe faljen e detyrimeve vendore të papaguara, ka shtuar ndjeshëm volumin e kërkesave dhe të verifikimeve që duhet të trajtojë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Qëllimi i shtesave: shërbime më cilësore dhe të ardhura më të larta

Të gjitha shtesat e propozuara u shërbejnë dy qëllimeve të ndërlidhura, të cilat përbëjnë thelbin e këtij projektvendimi.

Së pari, ato synojnë përmirësimin e shërbimeve që Bashkia u ofron qytetarëve. Shtesat në Ndërmarrjen e Pastrimit, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike dhe në Arsim kanë për qëllim mbulimin e plotë dhe të vazhdueshëm të territorit, reagimin më të shpejtë ndaj kërkesave të banorëve, mirëmbajtjen e investimeve publike dhe përballimin e ngarkesës së sezonit turistik pa lënë asnjë zonë të qytetit pa shërbim. Kjo përbën përmbushje të drejtpërdrejtë të funksioneve të veta të bashkisë, të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 139/2015.

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Së dyti, ato synojnë rritjen e të ardhurave vendore nëpërmjet efiçencës së menaxhimit financiar të mbledhjes së tyre. Forcimi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ka për qëllim që çdo detyrim fiskal i krijuar në territor të vlerësohet saktë, të faturohet në kohë, të ndiqet deri në arkëtim dhe të rakordohet me evidencat financiare, në përputhje me parimet e ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit të Ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Këto dy qëllime janë të lidhura ngushtë. Shërbimet më cilësore rrisin besimin dhe gatishmërinë e qytetarëve e të subjekteve për të shlyer detyrimet vendore, ndërsa të ardhurat më të larta krijojnë hapësirë financiare për ruajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve. Në këtë kuptim, shtesat e propozuara nuk përbëjnë thjesht kosto, por investim në kapacitetin e Bashkisë për të ofruar shërbime dhe për të siguruar burimet e veta të financimit.

III. Pasqyra krahasuese e numrit të punonjësve 2026 – 2027

Institucioni / Struktura	Nr. 2026	Pozicione të reja	Transferime	Nr. 2027
Administrata e Bashkisë	416	+5	−16	405
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	150	+21	+16	187
Ndërmarrja e Pastrimit	333	+30	–	363
Arsimi (jomësimorë / mësues ndihmës / inspektor QKF)	51	+10	–	61
Qendra Kulturore	30	+2	–	32
Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane	39	+1	–	40
Çerdhet	23	–	–	23
Konvikti (Arsimi profesional)	16	–	–	16
Teatri "Petro Marko"	31	–	–	31
Klubi Shumësportësh "Flamurtari"	17	–	–	17
Qendra e Zhvillimit PAK	22	–	–	22
Qendra Ditore e të Moshuarve	4	–	–	4
Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen	11	–	–	11
Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me AK	14	–	–	14
Zyra e Gjendjes Civile	14	–	–	14
Arsimi parashkollor / jomësimorë (sistemi 9-vjeçar)	355	–	–	355
Arsimi i mesëm, punonjës jomësimorë	51	–	–	51
Drejtoria e MZSH	50	–	–	50
TOTALI	**1627**	**+69**	**0**	**1696**

Nga 69 pozicionet e reja, 30 i shtohen Ndërmarrjes së Pastrimit, 21 Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, 10 Arsimit, 5 Administratës, 2 Qendrës Kulturore dhe 1 Ndërmarrjes së Menaxhimit të Mbetjeve. Pra, 61 nga 69 pozicionet, ose rreth 88% e shtesës, shkojnë drejtpërdrejt te shërbimet që qytetari i përdor çdo ditë: pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, mirëmbajtja e rrugëve, e plazheve dhe e kanaleve, si dhe shërbimi në institucionet arsimore.

Transferimi i 16 pozicioneve nga Administrata në Sektorin "Rrugë, trotuare, plazhe, DDD" të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nuk ndikon në numrin total.

IV. Arsyetimi i shtesave sipas strukturave

1. Administrata e Bashkisë – forcimi i administrimit fiskal (+5 pozicione)

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore përbën funksion thelbësor të vetëqeverisjes vendore, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e të ardhurave të veta të Bashkisë dhe me financimin e shërbimeve publike, në përputhje me Ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ushtron procese të vazhdueshme identifikimi, vlerësimi, faturimi, evidentimi të pagesave, ndjekjeje të detyrimeve të papaguara dhe raportimi financiar, të cilat varen nga informacioni që përcjellin drejtoritë e tjera të Bashkisë.

Nevoja për forcimin e kësaj drejtorie mbështetet edhe në rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të pasqyruar në Raportin e Auditimit datë 13.08.2026, faqe 63, pika 4.2, ku rekomandohet analizimi i mundësisë së ndryshimeve në strukturën përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim centralizimin e përgjegjësive dhe përmirësimin e planifikimit e të koordinimit të treguesve të të ardhurave. Ky rekomandim përbën bazë institucionale për rishikimin e organizimit të funksionit fiskal dhe të kapaciteteve njerëzore përkatëse.

Në këtë kuadër, propozohet shtimi i 4 (katër) pozicioneve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore:

- **2 (dy) specialistë**, për mbështetjen e proceseve të administrimit të detyrimeve vendore, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave të tatimpaguesve, ndjekjen e detyrimeve të papaguara, rakordimin e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe përmirësimin e komunikimit dhe të shërbimit ndaj subjekteve dhe qytetarëve. Ndarja konkrete e detyrave të tyre do të përcaktohet në përputhje me nevojat funksionale dhe strukturën e miratuar të Drejtorisë
- **1 (një) specialist jurist**, për trajtimin e çështjeve ligjore që lidhen me administrimin e taksave dhe tarifave vendore, shqyrtimin e akteve dhe praktikave administrative, përgatitjen e shkresave dhe qëndrimeve ligjore, si dhe asistimin në ndjekjen e procedurave të ankimit dhe të mbledhjes me forcë të detyrimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **1 (një) specialist IT**, për administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve elektronike të taksave, garantimin e cilësisë e të integritetit të të dhënave dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet strukturave të Bashkisë.

Këto pozicione do të mundësojnë një regjistër të plotë e të përditësuar të tatimpaguesve dhe të detyrimeve, faturim në kohë dhe pa mbivendosje ndërmjet strukturave, ndjekje sistematike të debitorëve, rakordim të plotë ndërmjet detyrimit, arkëtimit dhe evidencës kontabël, si dhe raportim të saktë për planifikimin buxhetor. Riorganizimi ruan parimin e ndarjes ndërmjet përgjegjësisë për ofrimin e shërbimit dhe përgjegjësisë për administrimin e detyrimit financiar, pa krijuar struktura paralele me kompetencat e drejtorive të tjera. Çdo përmirësim në shkallën e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore përkthehet drejtpërdrejt në burime shtesë për shërbimet publike, pa rritur barrën fiskale mbi qytetarët.

Pozicioni i pestë është **1 (një) punonjëse sanitare**, në shërbim të Zyrës së Gjendjes Civile dhe të rajoneve, për të garantuar kushte higjieno-sanitare të përshtatshme në mjediset ku qytetarët marrin shërbime administrative çdo ditë.

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Krahas shtesave, nga Administrata transferohen 16 pozicione në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, siç u shpjegua më sipër. Për rrjedhojë, numri i punonjësve të Administratës zbret nga 416 në 405.

2. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike – ndriçimi, kanalet, rrugët dhe plazhet (+21 pozicione të reja dhe 16 të transferuara)

Shtesat në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike mbështeten në funksionet e veta të bashkisë sipas nenit 23 të Ligjit nr. 139/2015, përkatësisht pika 3, "mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara", pika 4, "ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore", pika 5, "ndriçimin e mjediseve publike", dhe pika 7, "ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit". Numri i punonjësve të ndërmarrjes rritet nga 150 në 187, si vijon:

Sektori	Nr. 2026	Shtesa	Nr. 2027	Përbërja e shtesës
Sektori i Ndriçimit	15	+10	25	1 inxhinier elektrik dhe 9 elektricistë
Sektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD	86	+18	104	1 specialist inxhinier, 1 topograf dhe 16 mirëmbajtës
Sektori i mirëmbajtjes së varrezave	26	+4	30	4 mirëmbajtës të varrezave
Bordi i Kullimit	19	+5	24	1 inxhinier dhe 4 punëtorë për kanalet kulluese
Rrugët rurale	4	–	4	–
Gjithsej	**150**	**+37**	**187**	**21 pozicione të reja dhe 16 të transferuara**

Sektori i Ndriçimit rritet me 10 pozicione. Rehabilitimi i rrugëve dhe rikualifikimi i blloqeve të banimit shtojnë çdo vit pika të reja ndriçimi që kërkojnë kontroll, riparim dhe ndërhyrje të shpejtë, ndërsa mungesa e ndriçimit në disa blloqe banimi mbetet ndër ankesat më të shpeshta të banorëve. Me vetëm 15 punonjës, sektori nuk arrin të mbulojë në kohë të gjithë rrjetin e qytetit dhe të njësive administrative.

Bordi i Kullimit rritet me 5 pozicione. Pastrimi i rregullt i kanaleve kulluese, veçanërisht përpara sezonit të reshjeve, është masë parandaluese ndaj përmbytjeve dhe lidhet edhe me detyrimet e Bashkisë sipas Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Përvoja e vitit 2026 tregoi se ndërhyrjet periodike nuk mjaftojnë dhe se nevojitet staf i përhershëm, i drejtuar nga një inxhinier.

Sektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD rritet me 18 pozicione, nga të cilat 16 janë punëtorë, dhe 2 janë pozicione të reja teknike, një inxhinier dhe një topograf, për mbikëqyrjen e punimeve të mirëmbajtjes dhe për matjet në terren. Sektori i mirëmbajtjes së varrezave rritet me 4 mirëmbajtës, për t'u përgjigjur nevojës për shërbim të rregullt në varrezat publike të qytetit dhe të njësive administrative.

Pa këto shtesa, investimet e kryera nga Bashkia rrezikojnë të amortizohen shpejt për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, çka në terma afatgjatë kushton më shumë se kostoja e stafit të ri.

3. Ndërmarrja e Pastrimit – shtrirja territoriale dhe vazhdimësia e shërbimit (+30 pozicione)

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Shtesa mbështetet në funksionet e nenit 23 të Ligjit nr. 139/2015, pika 9, "parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike", dhe pika 10, "mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake", si dhe në nenin 26 të tij për masat vendore të mbrojtjes së mjedisit.

Numri prej 30 (tridhjetë) punëtorësh është rezultat i analizës së punës së ndërmarrjes gjatë vitit 2026, i nevojave të evidentuara në terren nga mbikëqyrësit e pesë rajoneve të qytetit dhe i planifikimit të shërbimit për vitin 2027. Gjatë vitit 2026, procesi i fshirjes është organizuar me ekipe të ndara për rrugët kryesore, rrugët dytësore dhe blloqet e banimit, sipas një grafiku me shërbim të përditshëm, një herë në dy ditë ose një herë në tri ditë. Rritja e kërkesës për shërbimin e pastrimit, kryesisht për fshirjen manuale, si dhe shtimi i mjeteve të ndërmarrjes, kërkojnë domosdoshmërisht shtimin e fuqisë punëtore në Sektorin e Terrenit dhe në Sektorin Teknik.

Qëllimi i shtesës është ruajtja e standardit të arritur dhe kalimi gradual drejt një shërbimi të përditshëm në të gjithë qytetin, në mënyrë që Vlora të jetë e pastër në çdo ditë të javës, edhe gjatë kulmit të sezonit turistik.

Shtesa justifikohet edhe nga natyra e vetë shërbimit dhe nga detyrimet e Kodit të Punës. Shërbimi i pastrimit kryhet çdo ditë, përfshirë ditët e diela, festat zyrtare dhe turnet e natës, pasi mbetjet urbane krijohen vazhdimisht dhe ndërprerja e shërbimit do të sillte përkeqësim të menjëhershëm të kushteve higjieno-sanitare. Nga ana tjetër, çdo punonjës gëzon të drejtën e pushimit javor, sipas nenit 79 të Kodit të Punës, dhe të pushimit vjetor të paguar, sipas nenit 92 të tij, i cili për punonjësit e ndërmarrjes është 22 ditë pune. Për rrjedhojë, një punonjës është realisht në dispozicion 291 ditë në vit (365 ditë – 52 ditë pushim javor – 22 ditë pushim vjetor), pra rreth 79% të ditëve të vitit, edhe pa llogaritur festat zyrtare dhe raportet mjekësore. Nga 333 punonjësit e ndërmarrjes, 300 janë punonjës terreni dhe mbështetës. Me këtë numër, kapaciteti efektiv ditor në terren është rreth 239 punonjës, ndërsa me shtesën e 30 punëtorëve, pra me 330 punonjës terreni dhe mbështetës, ky kapacitet arrin në rreth 263 punonjës çdo ditë.

4. Arsimi – mësues ndihmës dhe siguria në shkolla (+10 pozicione)

Në strukturën e Arsimit propozohet shtimi i 10 (dhjetë) pozicioneve, nga 51 në 61 punonjës:

- **5 (pesë) mësues ndihmës**, për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të Bashkisë. Sipas nenit 65 të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues". Mësuesi ndihmës është kusht për përfshirjen e plotë të këtyre fëmijëve në procesin mësimor.
- **5 (pesë) roje**, për sigurinë e nxënësve, të personelit dhe të mjediseve shkollore, në përmbushje të përgjegjësisë së Bashkisë për ndërtesat arsimore të sistemit parauniversitar, sipas nenit 23, pika 11, të Ligjit nr. 139/2015 dhe bazuar në kërkesat e drejtorive të institucioneve arsimore.

Në **Qendrën Kulturore** propozohet shtimi i 2 (dy) pozicioneve, një fonist dhe një specialist, të cilët do t'u shërbejnë veprimtarive të Qendrës Kulturore dhe të institucioneve të tjera kulturore të

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Bashkisë. Shtesa lidhet me numrin e madh të festivaleve, koncerteve, panaireve dhe eventeve sezonale që Bashkia organizon gjatë gjithë vitit, në përmbushje të funksionit të nenit 25, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, për "organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal".

Në **Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane** propozohet shtimi i 1 (një) specialisti inxhinier, për mbikëqyrjen teknike të infrastrukturës dhe të pajisjeve të reja të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve, të vëna në funksion në kuadër të Programit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Vlorë – Selenicë, të financuar në bashkëpunim me KfW. Investimet e kësaj natyre kërkojnë mbikëqyrje profesionale të vazhdueshme për të ruajtur funksionimin dhe garancitë e pajisjeve.

V. Për pikën 3 të projektvendimit

Me pikën 3 të projektvendimit propozohet miratimi i klasës dhe i shtesës për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe të institucioneve të varësisë, sipas tabelave nr. 1 deri nr. 11 bashkëlidhur projektvendimit. Klasat dhe shtesat për pozicion janë përcaktuar në përputhje me VKM-në nr. 328, datë 31.5.2023, të ndryshuar me VKM-në nr. 103, datë 11.2.2026, për nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë, si dhe me VKM-në nr. 326, datë 31.5.2023, të ndryshuar me VKM-në nr. 87, datë 6.2.2026, për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e specialiteteve të ndryshme. Pozicionet e reja klasifikohen në të njëjtat klasa page me pozicionet ekzistuese me përmbajtje të njëjtë pune.

Propozimi është ndërtuar mbi parimin e përgjegjshmërisë fiskale. Rritja neto e numrit të punonjësve është e kufizuar në 4,2%. Çdo shtesë rrjedh nga analiza e ngarkesës reale të punës gjatë vitit 2026 dhe nga planifikimi i shërbimeve për vitin 2027, ndërsa lëvizjet ndërmjet strukturave bëhen me burime ekzistuese. Shtesa në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore synon drejtpërdrejt rritjen e të ardhurave të veta të Bashkisë nëpërmjet një mbledhjeje më efiçente të detyrimeve vendore, duke kompensuar kështu një pjesë të kostos së pozicioneve të reja. Pozicionet e reja do të plotësohen gradualisht gjatë vitit, sipas procedurave ligjore të rekrutimit, çka e zbut më tej efektin në fondin e pagave të vitit 2027.

VI. Përfundime

Për sa më sipër, duke qenë se projektvendimi:

- mbështetet në funksionet dhe kompetencat që Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i ngarkon Bashkisë;
- bazohet në analizën e ngarkesës reale të punës dhe në problematikat e evidentuara gjatë vitit 2026;
- synon njëkohësisht përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritjen e të ardhurave vendore;
- është në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe me mundësitë financiare të buxhetit të vitit 2027,

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

i kërkojmë Këshillit Bashkiak shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2027".

Ju faleminderit!

DREJTOR

Loreta Nebiu

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al